



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI JURIDIK**



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS  
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

## **FAKULTETI JURIDIK (UP) SHPALL THIRRJE PËR APLIKIM TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E CERTIFIKIMIT “KLINIKA CIVILE”**

Me qëllim të zbatimit të misionit të Qendrës për Studime Klinike të Fakultetit Juridik (QSK) dhe programit të fakultetit, respektivisht klinikave ligjore, Fakulteti Juridik (UP) shpall thirrje për aplikimin e studentëve të Fakultetit Juridik që të jenë pjesë e grupit prej **20 studentëve** të programit të certifikimit në kuadër të Klinikës Civile, ku përmes praktikës, simulimit të rasteve dhe monitorimit të seancave gjyqësore, do të avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre profesionale, me qëllim të përgaditjes sa më të mirë për tregun e punës.

Qendra për Studime Klinike (QSK) në kuadër të Fakultetit Juridik UP, ndër të tjera ka për qëllim zhvillimin e shkathtësive praktike për studentët, aftësimin profesional dhe përgatitjen për tregun e punës.

Zbatimi i Programit të Certifikimit “Klinika Civile” realizohet me mbështetjen financiare të OHCHR/UNMIK në kuadër të projektit “Avancimi i të Drejtave të Njeriut: Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) dhe studentëve për ndryshime pozitive në Kosovë” në kuadër të mbështetjes së Fakultetit Juridik UP (me qëllim të realizimit të programit dhe objektivave të fakultetit), e që implementohet nga YIHR KS.

Studentët të cilët pranohen në programin e certifikimit të Klinikës Civile do të aftësohen në Qendrën për Studime Klinike (QSK), nga Profesorët e Fakultetit Juridik, Gjyqtarët dhe Avokatët, të cilët do të angazhohen në kuadër të marrëveshjeve që ka Fakulteti Juridik me Këshillin Gjyqësor (KGJK), Këshillin Prokurorial (KPK) dhe Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Plan programi i Klinikës Civile është i përgatitur me akterët e tregut të punës dhe i akredituar nga institucionet kompetente. Pas përfundimit të programit, studentët pjesëmarrës do të pajisen me certifikata dhe do të përfitojnë kredi shtesë (4 ECTS), të cilat do të vendosen në shtojcën e diplomës.

### **Studentët e interesuar për të qenë pjesë e këtij programi, duhet të plotësojnë këto kritere të kualifikimit:**

- Të jetë student/e aktiv i/e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në studimet Bachelor (apo Master nëprogramin E Drejta Civile);
- Studentët e studimeve Bachelor duhet të kenë të përfunduar së paku semestrin IV dhe të kenë të regjistruar semestrin V;
- Të ketë notën mesatare, së paku 8.00;
- Të ketë shkathtësi analitike dhe komunikuese;
- Të posedojë shkathtësi bazike të përdorimit të Teknologjisë Informative.

### **Dokumentet e kërkuara për aplikim:**

- CV e studentit/es;
- Vërtetimi i notave nga sistemi SEMS;
- Dëshmia e statusit të studentit/es të rregullt dhe aktiv.

### **Kohëzgjatja e programit dhe kriteret e certifikimit:**

Programi i Klinikës Civile zgjatë deri në 12 javë dhe në përfundim të programit, studentët pjesëmarrës do të marrin certifikata dhe ECTS. Kandidatët duhet të jenë të rregullt në aktivitetet e Klinikës Civile, në të kundërtën nuk certifikohen dhe zëvendësohen me studentët/et e tjerë /a nga lista pritëse.

### **Mënyra e aplikimit:**

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen të skanuara në formë elektronike në emailin: [gsk.juridiku@uni-pr.edu](mailto:gsk.juridiku@uni-pr.edu) deri me datën **07.02.2024** ne ora **16:00**. Aplikacionet e pranuar pas këtij afati nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

### **Sqarim:**

- Studentët të cilët pranohen në Klinikën Penale, nuk mund të vijojnë procesin edhe në Klinikën Civile;
- Procesi mësimor në Klinikën Civile dhe Penale do të fillojë me datë **15.02.2024**.